



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:059029
Datë: 02.02.2024
Numri i dokumentit: 05280298

AA.nr.55/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësve, M.J dhe J.J nga Zubin Potoku, kundër të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Organi i shpronësimit, me baze juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.534/2023, të datës 19.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.01.2024, merr këtë.

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësve, M.J dhe J.J nga Zubin Potoku, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.534/2023, i datës 19.12.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.534/2023, të datës 19.12.2023, është vendosur, “Hedhet poshtë padia e paditësve M.J dhe J.J, e ushtruar kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, me shenjën A.Nr.534/2023 të datës 07.03.2023.

Kundër aktvendimit të lartpërmendur, me kohë kanë paraqitur ankesë paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale të konfliktit administrativ dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktvendimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe lënda ti kthehet të njëjtës në rivendosje për ligjshmërinë e aktit administrativ-vendimit të Qeverisë së Kosovës nr. 02/124 të datës 02.02.2023.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 140, 194, 195, 200, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të

aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjen se ankesa e paditësve është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit kanë ushtruar padi për konflikt administrativ me datë 07.03.2023, duke kontestuar vendimin e të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Nr.02/124 i datës 02.02.2023, nga arsyet e dhëna në padi, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimin e kundërshtuar, pas shqyrtimit paraprak të padisë jashtë seance, bie aktvendimin e ankimuar, ku hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësve, me arsyetim se për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së padisë, gjykata e shkallës së parë iu referua Ligjit për Konfliktet Administrative, përkatësisht nenit 9, i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*. Ndërsa me nenin 10, paragrafin 1 të po të njëjtit Ligj, përcaktohet se: *“1. Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”*. Po ashtu gjykata e shkallës së parë iu referua edhe nenit 15.1.2 të të njëjtit ligj, i cili rregullon rastet kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, ku përcaktohet se: *“Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”*. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dhe duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, se vendimet e nxjerra nga e paditura, përkatësisht vendimet Nr.02//124 i dt.02.02.2023 nuk përbën akt administrative përfundimtare ndaj të cilave mund të iniciohet konflikt administrativ dhe rrjedhimisht gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në raport me këtë lloj të vendimeve, nuk mund të hapet konflikti administrativ me padi. Gjykata e shkallës së parë nga informacionit e sistemit smil ka konstatuar se për këto palë kundër vendimit preliminar Nr.09/142 te dt.10.05.2023 te lëshuar nga e paditura pas aktit të kontestuar me këtë padi është duke u zhvilluar procedura në konfliktin administrativ e udhëhequr sipas padisë A.1172/2023. Prandaj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar akët administrative të goditura me këtë padi, nuk janë akte përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative dhe rrjedhimisht nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e këtyre vendimeve në konflikt administrativ.

Kolegji i Gjykatës së Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjithashtu edhe Ligji për Konfliktet Administrative është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, në rastin konkret nuk janë plotësuar prezumimet procedurale për iniciimin e konfliktit administrativ ashtu siç është përcaktuar me nenin 9 lidhur me nenin 13 dhe 14 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kolegji apelit e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një përfundim të tillë të Gjykatës së shkallës së parë.

Sepse, kolegji i apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka hedhur poshtë si të pa lejuar padinë e paditësve, kjo për faktin se me dispozitën e nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”. Ndërsa me nenin 10 par.1 të te njëjtit ligj, është përcaktuar se “Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”. Kurse me dispozitën e nenit 15 par.1 pika 1.2 të te njëjtit ligj, i cili rregullon rastet se kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, përcaktohet se “1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”. Po ashtu, me dispozitën ligjore nga neni 34 par.1 pika 1.5 të te njëjtit ligj është përcaktuar se “1. Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: 1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ”.

Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, siç u theksua drejtë ka vendosur kur ka hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësve në këtë çështje juridiko-administrative, ngase vendimi i të paditurës i kontestuar me padi nga paditësit, Nr.02/124 i datës 02.02.2023, nuk është vendim përfundimtar në procedurë administrative, dhe në raport me këtë lloj të vendimit nuk mund të hapet konflikt administrativ me padi, por konflikti administrativ mund të hapet vetëm në raport me vendimin preliminar dhe përfundimtar, i cili merret nga organi i shpronësimit dhe atë në pajtim me nenin 35 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i cili përcakton se “1. Nëse një Person është Pronar ose Zotërues i një Interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i procedurës së shpronësimit dhe ky person me arsye mendon se Vendimi Preliminar (ose cilado pjesë e tij) është në kundërshtim me një ose më shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 4 të këtij ligji, ky person ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e Vendimit Preliminar, pjesërisht ose plotësisht.. 2. Nëse Organi Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. 3. Ankesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datën së hyrjes në fuqi të Vendimit Preliminar, siç është përcaktuar në paragrafin 5. të nenit 10 të këtij ligji. Nëse ankesa dorëzohet pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore kalendarike, ajo do të refuzohet nga gjykata.”

Gjithashtu edhe me nenin 36 të te njëjtit ligj është përcaktuar se “1. Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një Vendim Përfundimtar, çdo Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t'i paguhen atij Pronari dhe/ose Zotëruesi të Interesit. 2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës”.

Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se në këtë çështje administrative nuk janë plotësuar kushtet, përkatësisht prezumimet procedurale për fillimin e konfliktit administrativ, ngase vendimet e të paditurës të kontestuar me padi nga paditësit siç u theksua më lartë, nuk janë

vendime preliminare, e as vendime përfundimtare në procedurën administrative, dhe në raport me këtë lloj të vendimeve nuk mund të hapet konflikt administrativ me padi.

Kolegji i apelit ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të paditësve se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit nuk ka dhënë arsye konkrete për se pse konsideron se kundër vendimit të lartcekur të Qeverisë së Kosovës nuk mund të hapet konflikt administrativ, shkaqet dhe arsyetimi janë kontradiktore në mes veti dhe se akti kundër të cilit nuk mund të fillohet procedura kundërvajtëse nuk është i bazuar në asnjë ligj, në rastin konkret vendimi i Qeverisë nr. 02/124 i datës 02.02.2023 me të cilin është vërtetuar interesi publik për eksproprijim të paluajtshmërisë paraqet akt administrativ kundër të cilit nuk është e lejuar ankesa në procedura administrative, mirëpo kundër këtij vendimi është e lejuar hapja e konfliktit administrativ, ngase me asnjë dispozitë ligjore nuk është përjashtuar mundësia e inicimit të konfliktit administrativ kundër vendimeve të Qeverisë me të cilat vërtetohet interesi publik për eksproprijim. Pastaj se Gjykata e shkallës së parë me arsyetimin e vendimit të saj nuk thirret në asnjë ligj që e përjashton inicimin e konfliktit administrativ kundër vendimeve të këtilla të Qeverisë, por vetëm thekson se kundër vendimit kontestues të Qeverisë së Kosovës nr. 02/124 të datës 02.02.2023 nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ. Ligji për Eksproprijim të pasurisë së paluajtshme është ligj i veçantë në të cilin me asnjë dispozitë nuk është paraparë përjashtimi i inicimit të konfliktit administrativ por përkundrazi, në bazë të nenit 39 par. 2 të këtij ligji është paraparë mundësia që vendimet dhe veprimet jashtë vendimit preliminar të jenë objekt i kontrollës gjyqësore në bazë të ligjit për procedurën administrative dhe ligjit për konfliktet administrative. Pastaj se ky vendim i Qeverisë është vendim për vërtetimin e interesit publik për eksproprijim të paluajtshmërisë në pronësi të paditësve, ndërsa vendimi preliminar është vendim me të cilin lejohet eksproprijimi, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuar për faktin se sipas dispozitave të sipërcituara të Ligjit nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/205, vendime që mund të konstatohen në gjykatë janë vetëm vendimi preliminar dhe përfundimtar i organit të shpronësimit, por jo edhe vendimet e kontestuar nga paditësit me të cilat është miratuar shpallja me interes të veçantë publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat janë të nevojshme për realizimin e “projekteve Infrastrukturore me interes publik”...

Prandaj, në situatën konkrete kolegji i apelit vendosi që ta refuzoj ankesën e paditësve, kurse aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ta vërtetoj.

Nga arsyet e dhëna më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 208 dhe nenin 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
AA.nr.55/2024, datë 29.01.2024

Kryetar i kolegjit,
Ramiz Kuqi